



„IBER-LEPENC” SH.A.
D.D.

01-2156 13.07.2010

PRISHTINE - PRIŠTINA



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE „IBER-LEPENC” SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE „IBER-LEPENC” J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE „IBER-LEPENC” D.D.

Sheshi "Bil Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Clinton" Br.13 Priština, Kosovo
Tel: 038/226-070, 225-006, Fax: 038/226-159; Email: iber_lepenci@hotmail.com

**RREGULLORE PËR MJETET PËR MBROJTJE PERSONALE DHE PAJISJET E
MBROJTJES NË PUNË**

PRISHTINË, MAJ PRILL 2010

A.B

12. Kryerja e punëve në kushte të veçanta (me rrezikshmëri të lartë), ku parashihen masa të veçanta të sigurisë në punë, mund t'iu besohet vetëm të punësuarve profesional, të aftësuar për kryerjen e këtyre punëve. Kryesit e këtyre punëve, apo ata që kanë qasje me to, duhet detajisht të informohen me rreziqet dhe masat për siguri në ato punë.

13. Punët të cilat kryhen nga disa të punësuar, për të pasur punë të sigurt kërkohet koordinim dhe marrëveshje midis tyre. Punëdhënësi ose personi përgjegjës i tij, duhet të caktojë një person me të cilin duhet t'i koordinojnë punët, i cili duhet të jetë në detaje i informuar për rrezikshmërinë dhe masat e sigurisë në ato punë.

Neni 3

Detyrat e të Punësuarve

(1) Të gjithë të punësuarit dhe tjerët të angazhuar në punë apo lidhur me punën, janë të obliguar t'iu përmbahen të gjitha normave, udhëzimeve dhe masave që kanë të bëjnë me parandalimin e rreziqeve në punë ose lidhur me punën, sëmundjeve profesionale dhe masave të tjera për mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës.

(2) Punëdhënësi, udhëheqësi i repartit, kryepunëtori si dhe punonjësi të cilit i është caktuar ndonjë i punësuar në cilësi të ndihmësit ose për aftësim, janë të obliguar për t'i njoftuar të punësuarit me të gjitha rreziqet në punë dhe lidhur me masat e sigurisë në punë.

(3) Të punësuarit që lëngojnë, apo kanë parashenja për të lëngur nga ndonjë smundje (ataku, marramendje, shkurtpamësi, shtangim i muskujve e të ngjashme), nuk mund të punësohen në punë ku paraqet rrezik për vet ata dhe për të punësuarit e tjerë. Të punësuarit nëse hetojnë shenja të këtyre sëmundjeve, janë të obliguar menjëherë ta lajmërojnë Punëdhënësin apo përgjegjësin e tyre.

Neni 4

Siguria e lëvizjes në punë

(1) Punëdhënësi është i obliguar, në ambientet e punës t'i eliminojë të gjitha pengesat për lëvizje, parregullsitë që paraqesin rrezik në punë dhe lidhur me punën. Në qoftë se nuk ka mundësi objektive për t'i eliminuar parregullsitë duhet të izolojnë respektivisht rrethohen me rrethoja të ndriçohen dhe shenohen në mënyrë adekuate.

(2) Në qoftë se oborri i ndërmarrjes shërben edhe për deponim të materialit, lëndës së parë, atëherë ai duhet të rregullohet në atë mënyrë, që mos të pengohet lëvizja e lirë dhe mos të paraqitet rrezik në punë për të punësuarit.

(3) Oborri i Ndërmarrjes, të gjitha vendet e punës dhe ato lidhur me punën, gjat punës në turnin e natës, duhet të jenë të ndriçuara, kurse vendet që paraqesin rrezik në punë apo lidhur me punën (gropat, kanalet etj.), duhet të shënohen (fiksohen) me shenjën që paraqet rrezik.

(4) Dyshemeja, hyrje-daljet dhe të gjitha vendet e punës, duhet të jenë në gjendje të rregulltë. Vendet e rrëshqitshme në dysheme duhet të mirëmbahen dhe të shënohen qartë.

H. B

RREGULLORE PËR MJETET PËR MBROJTJE PERSONALE DHE PAJISJET E MBROJTJES NË PUNË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1

(1) Masat higjienike dhe teknike të sigurisë në punë, të parapara me këtë Rregullore, aplikohen në të gjitha vendet e punës, përveç në ato ku kryhen punë në kushte të veçanta, ku krahas këtyre parashihen edhe masa tjera të shtesë të sigurisë në punë.

(2) Për punët në të cilat punëmarrësit i'u ekspozohen rreziqeve, natyra e të cilave kërkon edhe masa tjera shtesë për siguri në punë, përveç masave të parapara me këtë Rregullore, aplikohen edhe masat shtesë të sigurisë në punë.

Neni 2

Detyrat e punëdhënësit

Punëdhënësi është i obliguar që:

1. T'i njoftoi të punësuarit me këtë Rregullore dhe dispozita tjera të veçanta, që kanë të bëjnë me sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës
2. Të gjitha vendet e punës dhe ato që lidhen me punën (punishtet, punëtoritë, ndërtesat, lokalet për pushim, ushqim, pastrim etj.), mjetet e punës, mjetet për siguri në punë, t'i rregulloj dhe t'i mirëmbaj në atë mënyrë, që të punësuarit dhe të tjerët, të jenë të mbrojtur nga fatkeqësitë në punë, sëmundjet profesionale dhe sëmundjet e tjera lidhur me punën.
3. T'i parashohë, për të gjitha vendet e punës, rreziqet dhe masat e sigurisë në punë.
4. Nëse mjetet e punës, paisjet e punës, punishtja, punëtoritë etj..., paraqesin rrezik për jetën apo shëndetin e të punësuarve, punëdhënësi ose personi përgjegjës i tij, duhet menjëherë t'i largoj nga përdorimi.
5. Vërejtjet për rreziqet në punë duhet të vihen në vende të theksuara dhe të dukshme.
6. Rugët dhe daljet emergjente, duhet të jenë në çdo kohë pa pengesa dhe të shënuara qartë.
7. T'i ndërmarr të gjitha veprimet, që të punësuarit dhe të tjerët që kanë lidhje me punën, t'i aplikojnë dhe t'u përmbahen të gjitha masave të parapara të sigurisë në punë.
8. Të krijoj kushte për bashkëpunim të të punësuarve për evitimin e shkaqeve të fatkeqësisë në punë.
9. Të kujdeset, që të gjitha mjetet e sigurisë në punë, në çdo kohë të jenë në gjendje të rregullt dhe të përdorshme. Në rast të prishjes me kohë të riparohen, kurse atyre që u ka skaduar afati të zëvendësohen me të reja.
10. Të bëjë matjet dhe kontrollimet periodike të parametrave teknike të mjeteve dhe pajisjeve të punës.
11. Me rastin e furnizimit me mjete të punës, lëndë të parë, aparate, mjete të transportit etj..., ato patjetër duhet të jenë të pajisura me mjete mbrojtëse dhe me ateste adekuate, konform standardeve ndërkombëtare.

A.B

(5) Vendet e rrezikshme të punës, duhet të shënohen qartë me tërheqje të vërejtjes për rrezikshmëri (rrezik për jetë, tensioni i lartë, mos prek etj...).

(6) Lokalet me stabilimente elektrike (të cilat paraqesin rrezik), gjat gjithë kohës duhet të mbyllen e t'u lejohe qasja dhe qëndrimi vetëm personave të autorizuar dhe profesional.

(7) Në lokalet e punës, ndërprerësit e rrymës, duhet të instalohen në vende të përshtatshme dhe të papengueshme.

(8) Dyert kryesore të lokaleve të punës (hyrje-daljet kryesore), duhet të jenë të gjëra së paku dy (2)m, ndërsa ato ndihmëse së paku një (1)m.

(9) Në të gjitha vendet ku punohet (punëtori, reparte etj...), të gjitha hyrje-daljet dhe kalimet e tjera (qarkullimi në punë), nuk guxon të ketë pengesa të cilat do të kishin penguar apo vështirësuar daljen, respektivisht lëvizjet në punë.

(10) Të punësuarit duhet t'i shfrytëzojnë vetëm ato hyrje-dalje, respektivisht kalime të caktuara për ta.

(11) Gjat ngritjes dhe bartjes së ngarkesave me vinç, ndalohet çdo kalim apo qëndrim nën ngarkesa.

(12) Të gjitha shkallët, kalimet, urat, etj..., të cilat janë mbi tokë në lartësi mbi një (1) metër, duhet të kenë patjetër rrethojën në lartësi adekuate.

(13) Për ngritje dhe bartje të ngarkesave, duhet të përdoren mjete adekuate të atestuara dhe duhet të aplikohen masat mbrojtëse adekuate.

(14) Skelet, të cilat përdoren në punë duhet të jenë nga materiali i qëndrueshëm dhe të siguruar nga rreshqitja, thyerja, rënia apo luhatja.

Neni 5

Mjetet, përkatësisht pajisjet të cilat shfrytëzohen nga punëtorët në vendet e punës, ku punëtori mund t'i ekspohet goditjes mekanike, elektrike, termike apo ndonjë goditje tjetër, duhet të jenë rezistuese në goditje, shpëputje, thyerje përkatësisht në përçueshmëri elektrike, termike në mënyrë që punëtori të jet i mbrojtur.

A.B

II. MJETET DHE PAJISJET PËR MBROJTJE PERSONALE

Neni 6

Në vështrim të Nenit 1. dhe 5. të kësaj Rregullore përcaktohen këto mjete, përkatësisht pajisje mbrojtëse, si:

1. Mjetet, gjegjësisht pajisjet për mbrojtjen e kokës;
2. Për mbrojtjen e syve dhe fytyrës;
3. Për mbrojtjen e shqisës së të dëgjuarit;
4. Për mbrojtjen e organeve të frymëmarrjes;
5. Për mbrojtjen e duarve;
6. Për mbrojtjen e këmbëve;
7. Për mbrojtjen e nyjeve të dorës, të supeve dhe të boshtit të kurrizit;
8. Për mbrojtjen e trupit;
9. Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues;
10. Për mbrojtjen nga ndikimet atmosferike;
11. Për mbrojtjen nga rënia prej lartësisë;
12. Për mbrojtjen nga mbytja në ujë;
13. Për mbrojtjen nga goditja prej energjisë elektrike.

Neni 7

Mjetet, gjegjësisht pajisjet për mbrojtjen e kokës

(1) Për mbrojtjen e kokës nga rënia e objekteve (gjësendeve) ose nga goditja gjat kryerjes së punëve ndërtimore, gjat shuarjes së zjarrit, gjat ndërtimit dhe riparimit të objekteve lënduese, gjat ngutjes, lëshimit ose riparimit të konstruksioneve të çelikta apo stabilimenteve dhe instrumenteve tjera, gjat ngarkimit dhe shkarkimit të paisjeve dhe objekteve tjera, me qëllim të mbrojtjes së kokës nga objektet e ndryshme në lokal dhe hapësirë ku punon si dhe për mbrojtjen e kokës nga goditja e rrymës, rastësisht, gjat kontaktit me ujë të elektrizuar, punëtorët të cilët vazhdimisht ose kohë pas kohe i kryejnë këto punë i jepen në shfrytëzim helmata mbrojtëse me standard ISO ose standarde dhe norma tjera adekuate për këtë lloj rreziku ose dëmtimi.

(2) Për mbrojtjen e kokës nga pluhuri dhe mbrojtjen e flokëve gjat punëve me makina rrotative (torno, cilindër, etj.) punëtorëve të cilët i kryejnë këto punë i jepen në shfrytëzim kapela, kasketa rrjeta për flokë, shamia ose mjete përkatësisht pajisje të ngjashme për kokë. Punëtorët të cilët vazhdimisht ose kohë pas kohe i kryejnë këto punë i jepen në shfrytëzim mjetet mbrojtëse adekuate.

Neni 8

Mjetet dhe pajisjet për mbrojtjen e syve dhe fytyrës

(1) Për mbrojtjen e syve gjat kryerjes së punëve që kryhen në mënyrë mekanike si lëmimit, mprehjes, brushimit, heqjes së mbeturinave nga saldimit, dhënies llaç përzierjes dhe sitjes së materialit, kryerjes së punëve me makina (mprehjes, formimit, gëlqerosjes, sharrimit, zdrukthimit, përpunimit të metalit, drurit, materialeve tjera të forta, etj.), si dhe gjat kryerjes së punëve mekanike dhe me makina (farkimit, gozhdimit, thyerjes dhe latimit të gurit, betonit, ose ndonjë materiali tjetër), gjat punës me

A. B

daltë ose të ngjashme ku ekziston rreziku i lëndimit nga thërrmijat ose shkëndijat e imta ose të mëdha, të cilat godasin drejtpërdrejtë, do të thotë në drejtim ballësor dhe anësor e me shpejtësi të madhe, punëtorëve që kryejnë këto punë i jepen në shfrytëzim syze mbrojtëse, për t'u mbrojtur (mbyllur) anash, apo syze tjera sipas standardeve ISO ose standarde dhe normave tjera për mbrojtje nga ky lloj rreziku ose dëmtimi.

(2) Për mbrojtjen e syve nga drita e fortë, shkëndijat, rrezet e dobëta termike dhe rrezet ultraviolete, gjat saldimit autogjen ose elektrolit, punëtorëve që iu ekspozohen këtij lloj rreziku iu jepen në shfrytëzim syze mbrojtëse, apo mjete ose pajisje tjera dëmtimi, sipas standardeve ISO ose standarde dhe normave tjera përkatëse,

(3) Për mbrojtjen e syve dhe fytyrës nga thërrmijat e mëdha që derdhen fluturimthi nga materiali i cili përpunohet dhe nga pikëzat ngacmuese të materialeve që mund të futen në sy, gjegjësisht ta lëndojnë fytyrën, jepet në shfrytëzim mbrojtësi për sy dhe fytyrë i mbyllur dhe jo i mbyllur, i cili në tërësi duhet plotësuar kushtet teknike dhe standardet në fuqi.

Neni 9

Mjetet dhe pajisjet për mbrojtjen e shqisës së të dëgjuari

Për mbrojtjen e shqisës së të dëgjuarit nga zhurma e tepërt, përkatësisht në punët dhe detyrat e punës ku zhurma nuk mund të zvogëlohet me mjete teknike apo në ndonjë mënyrë tjetër deri në kufijtë e lejuar, siç është e përcaktuar me dispozitat në fuqi, punëtorëve që i ekspozohen këtij lloj rreziku i jepen në shfrytëzim mjetet përkatëse, gjegjësisht pajisjet varësisht nga intensiteti i zhurmës. sipas standardeve ISO ose standarde dhe normave tjera përkatëse, si:

1. Pambuk, për mbrojtjen e shqisës së të dëgjuarit nga zhurma deri në 75 dB;
2. Tampon, për mbrojtjen e shqisës së të dëgjuarit nga zhurma deri në 85 dB;
3. Mbrojtës për vesh,, për mbrojtjen e shqisës së të dëgjuarit nga zhurma deri në 105 dB.

Neni 10

Mjetet dhe pajisjet për mbrojtjen e organeve të frymëmarrjes

(1) Për mbrojtjen e organeve të frymëmarrjes gjat punës në ambient të ndotur nga gazrat dëmtuese (pluhuri, mjegulla), me koncentrim mbi maksimumin e lejuar, punëtorëve që punojnë në këto ambiente u jepen në shfrytëzim mjete përkatëse, gjegjësisht pajisje për mbrojtjen e organeve të frymëmarrjes.

(2) Mjetet dhe pajisjet për mbrojtjen e organeve të frymëmarrjes, gjat përdorimit, nuk guxojnë të vështirësojnë frymëmarrjen normale dhe duhet të jenë të përshtatshme për përdorim të shpejtë dhe të lehtë.

A.B

Neni 11

Mjetet dhe pajisjet për mbrojtjen e duarve

(1) Për mbrojtjen e duarve nga rreziku i caktuar, varësisht nga lloji i punëve, jepen në shfrytëzim dorëza mbrojtëse dhe ate:

1. Për mbrojtjen e duarve nga lëndimet mekanike (shpuarjes, prerjes, gërvishtjes, djegies, etj), ku ekziston rreziku nga lëndimet e tilla, jepen në shfrytëzim dorëza mbrojtëse të lëkurës, të cilat mund të jenë të kombinuara edhe me material tekstili;
2. Dorëza për saldim për mbrojtjen e duarve nga materiali i salduar, rrezatimi termik dhe ultraviolet dhe nga djegia gjat kontaktit me material të nxehtë;
3. Dorëza nga lëkura natyrale ose sintetike për mbrojtjen e duarve nga ndikimi i dëmshëm i materieve dhe materialeve ngacmuese, materieve infektuese, thartirës, alkoolit dhe si dhe ndotjet e tjera të ngjashme e të dëmshme.
4. Dorëza gome për elektrikist për mbrojtjen sekondare nga goditja e energjisë elektrike gjat kryerjes së punëve në stabilimente elektrike, punëtorëve që kryejnë punë të tilla u jepen në shfrytëzim dorëza sipas standardeve ISO ose standardeve dhe normave tjera për mbrojtjen nga goditja e energjisë elektrike gjat kontaktit me pajisjet nën tension.

(2) Për mbrojtjen nga goditja e energjisë elektrike gjat kryerjes së punëve nga pika paraprake, duhen të ndërmerren edhe masa tjera mbrojtëse si përdorimi i veglave dhe pajisjeve të izoluara, tokëzimi, etj.

Neni 12

Mjetet dhe pajisjet për mbrojtjen e këmbëve

Për mbrojtjen e këmbëve prej goditjes nga veglat ose gjësendet e rënda, materialeve, nga lëndimet mekanike, nga uji, lagështia, balta dhe rreziqet tjera të caktuara, punëtorëve që kryejnë punë të tilla u jepen në shfrytëzim, varësisht nga lloji i punëve, këpucë mbrojtëse, çizme gome, të gjata ose të shkurta, varësisht nga lloji i punëve, këpucë gome, çizme llastiku për mbrojtjen e këmbëve nga goditja e energjisë elektrike etj.

Neni 13

Mjetet dhe pajisjet për mbrojtjen e nyjeve të dorës, supit dhe të boshtit të kurrizit

(1) Për mbrojtjen e nyjeve të dorës gjat manipulimit me vegla me maje të mprehtë, gjat punëve të rënda fizike dhe të transportit, punëtorëve që kryejnë punë të tilla u jepen në shfrytëzim mbrojtësit e lëkurës për nyje të dorës;

(2) Për mbrojtjen e boshtit të kurrizit nga deformimi për shkak të bartjes së gjësendeve (objekteve) të rënda në krah dhe në shpinë, punëtorëve që kryejnë punë të tilla u jepet në shfrytëzim jeleku mbrojtës;

H.B

(3) Për mbrojtjen e krahërorit për shkak të bartjes së gjësendeve (objekteve) të rënda mbi 15kg; dhe gjat bartjes së barrës me maje të mprehtë, punëtorëve që kryejnë punë të tilla u jepet në shfrytëzim jeleku mbrojtës i lëkurës.

Neni 14

Mjetet dhe pajisjet për mbrojtjen e trupit

Në qoftë se gjat punës punëtori i ekspozohet ndikimit biologjik të dëmshëm të procesit teknik si ndotja, pluhuri, lagështia, temperatura e lartë dhe e ulët, punëtorëve që kryejnë punë të tilla u jepen në shfrytëzim rroba mbrojtëse, si:

1. Rroba prej pëlhure të qepura prej një pjese (mantillë) ose prej dy pjesësh (xhaketa ose këmisha dhe pantallona) për punë në makina, stabilimente dhe instalime, ku punëtori i ekspozohet ndotjes dhe pluhurit gjat montimit, çmontimit të veglave të punës, nstrumenteve dhe stabilimenteve (Industriale, ndërtimore, bujqësore dhe të komunikacionit) gjat pastrimit, bartjes ljerjes, lubrifikimit, konservimit dhe mbrojtjes sipërfaqësore të pjesëve të makinave dhe instalimeve.
2. Materiali i butë dhe i padepërtueshëm ose prej pëlhure, brenda me astar pambuku, për punë gjat larjes dhe lubrifikimit ose riparimit të pjesëve të ambienteve dhe mjeteve transportuese.

Neni 15

Mjetet dhe pajisjet për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues

Në qoftë se gjat punës punëtori vazhdimisht apo kohë pas kohe i ekspozohet burimeve jonizuese apo rrezatimeve tjera të rrezikshme dhe të dëmshme për shëndetin dhe jetën e punëtorit, punëtorëve të cilët kryejnë punë të tilla iu jepen në shfrytëzim këto pajisje, përkatësisht mjete, si:

1. Përparëse mbrojtëse dhe dorëza mbrojtëse prej gome ;
2. Respirator me filtër për mbrojtjen e organeve për frymëmarrje nga pluhuri jonizues dhe radioaktiv.

Neni 16

Mjetet dhe pajisjet për mbrojtje nga ndikimet atmosferike

Në qoftë se gjat punës në hapësirë punëtori i ekspozohet ndikimeve atmosferike të pavolitshme (shiu, bora, temperaturat e larta apo të ulëta. etj.) jepen në shfrytëzim mjetet përkatësisht pajisjet, si:

1. Mantil shiu me kësulë prej gome dhe jo-depërtues;
2. Bundë e shkurtër ose e gjatë (varësisht nga lloji i punëve të cilat i kryen punëtori) nga materiali maltoprem ose nga ndonjë material tjetër;
3. Çizme gome (të gjata ose të shkurta) varësisht nga lloji i punëve.

Neni 17

Mjetet dhe pajisjet për mbrojtje nga rënia prej lartësisë

A. B.

Për mbrojtje nga rënia prej lartësisë gjat kryerjes së punëve jepen në shfrytëzim brezi mbrojtës me konop, sipas nevojës si dhe pajisjet me mjetet përbërëse.

Neni 18

Mjetet dhe pajisjet për mbrojtje nga mbytja në ujë

Për mbrojtjen nga mbytja në ujë, gjat punimeve mbi ujë, në lumenj dhe liqej, ose në objekte lundruese jepet në shfrytëzim brezi mbrojtës, përkatësisht brezi për shpëtim.

Neni 19

Mjetet dhe pajisjet për mbrojtje nga goditja e energjisë elektrike

(1) Mjetet personale mbrojtëse, pajisjet mbrojtëse dhe veglat izoluese që shërbejnë për punë në objekte elektro-energjetike, stabilimente dhe instalime duhet të jenë të shqyrtuara dhe atestuara sipas standardeve dhe normave përkatëse;

1. Pajisjet mbrojtëse personale, përkatësisht veglat duhet të zgjidhen sipas tensioneve të instaluar.
2. Pajisjet dhe mjetet personale mbrojtëse si dhe veglat para përdorimit patjetër duhet kontrolluar në mënyrë vizuale se a janë të dëmtuara.
3. Mjetet (veglat) e dëmtuara nuk guxojnë të përdoren.
4. Mjetet izoluese mbrojtëse dhe pajisjet izoluese mbrojtëse duhet të kontrollohen kohë pas kohe në periudha të caktuara, në pajtim me normat dhe standardet përkatëse.
5. Për kontrollimin e afatit të rregullësisë (ekzekutimit) në mjete dhe pajisje duhet të ekzistoj shenja dhe vula e organizatës, e cila e ka bërë këtë, ku ceket data e ekzaminimit dhe udhëheqësit të punëve, të cilët mbajnë evidencë të veçantë për të njëjtat.
6. Mjetet mbrojtëse izoluese, pajisjet mbrojtëse izoluese dhe veglat mbrojtëse izoluese duhet të ruhen në lokale të përshtatshme dhe të thata ku nuk i nënshtrohen ndikimeve të dëmshme.

(2) Gjat manipulimit dhe punës në objekte elektro-energjetike, përdoren dhe shfrytëzohen mjetet dhe pajisjet për mbrojtjen personale si:

1. Helmeta mbrojtëse (ISO), e cila duhet pa tjetër të përdoret gjat operimeve dhe punimeve në objekte dhe stabilimente;
2. Indikatorit i tensionit, i cili zbatohet për përcaktimin e gjendjes së atestit;
3. Shkopi izolues, i cili shfrytëzohet për vënien - heqjen e pajisjeve përçuese për tokëzim dhe lidhje të shkurtë, për vënien - heqjen e pllakave mbrojtëse izoluese për manipulim, etj;
4. Pllakat mbrojtëse izoluese (ISO), ndarëset (ISO), mbulesat, etj. të cilat shfrytëzohen gjat punimeve si mbrojtëse nga prekja e rastit të pjesëve nën tension;
5. Veglat bartëse për tokëzim dhe lidhje të shkurtër që shërbejnë për lidhje të shkurtër të përkohshme dhe tokëzimin e pjesëve të cilat në punë normale janë nën tension;
6. Syzet mbrojtëse dhe mbrojtësi që shërbejnë për mbrojtjen e supeve respektivisht fytyrës të paraqitja e qarkut elektrik;
7. Dorëzat mbrojtëse prej lëkure që shërbejnë si mjete mbrojtëse nga lëndimet mekanike dhe kimike të duarve dhe nga djegia;
8. Dorëzat mbrojtëse prej gome (ISO) që shërbejnë në raste të caktuara si mjete mbrojtëse nga goditja e energjisë elektrike;

A. B

9. Rrobat e punës për mbrojtjen e trupit dhe pjesëve të trupit nga lëndimet mekanike dhe kimike dhe djegia tek paraqitja e qarkut elektrik si dhe gjat operimit dhe punës në objekte dhe stabilimente.

10. Brezi siguries që shërben për mbrojtjen nga rënia prej lartësisë dhe shfrytëzohet në lartësi prej me tepër se 3 metra.

11. Veglat izoluese që shërbejnë për kryerjen e punëve nën tension në hapin siguries.

(3) Mjetet dhe pajisjet tjera të cilat përcaktohen se janë të domosdoshme për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punëtorit gjat punëve në objekte dhe stabilimente elektro-energjetike.

III. FURNIZIMI DHE MIREMBAJTJA E MJETEVE DHE PAJISJEVE PËR MBROJTJEN PERSONALE TË PUNËTORËVE NË PUNË

Neni 20

Punëdhënësi është i obliguar t'i siguroj mjetet mbrojtëse dhe pajisjet, që janë lëndë e kësaj rregulloreje dhe t'iu jepen në disponim punëtorëve për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit nga rreziku dhe dëmtimi i papritur si dhe rreziku dhe dëmtimi i kohëpaskohshëm që paraqiten gjat kryerjes së punëve dhe detyrave të punës.

Neni 21

Shërbimi i autorizuar për furnizim, kur ka të bëjë me furnizimin e automjeteve dhe pajisjeve mbrojtëse personale është i obliguar të bashkëpunoj drejtpërdrejtë me punëtorin e përcaktuar me punë të mbrojtjes në punë dhe gjat furnizimit të mjeteve dhe pajisjeve nga liferuesi domosdo të kërkoj dokumentin me shkrim (atestin) që vërteton se mjetet personale mbrojtëse dhe pajisjet i përgjigjen dedikimit përkatësisht rregullave si standardi dhe kualiteti.

Neni 22

(1) Punëdhënësi është i obliguar t'i mbaj në gjendje të rregullt dhe të përkryer të gjitha mjetet mbrojtëse personale dhe pajisjet tjera që janë lëndë e kësaj rregulloreje.

(2) Mjetet e dëmtuara, grisura, përkatësisht mjetet e vjetërsuara të cilat nuk mund të rregullohen për përdorim të mëtejshëm duhet të çregjistrohen pavarësisht nga afati dhe koha e shfrytëzimit.

Neni 23

Mjetet dhe pajisjet që vihen në kokë (helmeta, kapela, etj.), në vesh (antifeni), në gojë (maskë gojë) dhe hundë (piskeza, mengjena) duhet që pas çdo përdorimi të dezinfektohen dhe pastrohen në qoftë se të njëjtin e përdor më shumë se një person.

A. B

**IV. TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E UDHËHEQËSIT TË
DREJTPËRDREJTË DHE PUNËTORIT LIDHUR ME SIGURIMIN DHE
SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE PAJISJEVE PËR MBROJTJEN PERSONALE NË
PUNË**

Neni 24

Udhëheqësi i drejtpërdrejtë është i obliguar që punëtorin ta njoftoj me burimin e rrezikut që paraqitet gjat kryerjes së punës dhe me kohë të ushtroj kërkesë për sigurimin e mjeteve përkatësisht pajisjeve mbrojtëse.

Neni 25

(1) Kur mjetet përkatësisht pajisjet i dorëzohen punëtorit për shfrytëzim ose përdorim të kohë pas kohshëm, pas kryerjes së punës, punëtori është i obliguar që këto mjete përkatësisht pajisje, të pastruara me rregull, t'i kthej në depo.

(2) Mjetet dhe pajisjet nga paragrafi paraprak depoisti, me pëlqimin e nevojshëm të punëtorit përgjegjës për mbrojtje në punë, i jep në revers, të cilin e vërteton udhëheqësi i drejtpërdrejtë i punëtorit.

Neni 26

(1) Pas skadimit të afatit të qëndrueshmërisë të mjeteve dhe pajisjeve mbrojtëse personale, ato regjistrohen.

(2) Nëse punëtorit i cili i ka marrë në shfrytëzim mjetet mbrojtëse personale i pushohet marrëdhënia e punës, afati i qëndrueshmërisë i shtyhet për aq kohë sa edhe i ka pushuar marrëdhënia e punës punëtorit.

Neni 27

(1) Punëtori ka të drejtë dhe detyrim t'i shfrytëzoj mjetet mbrojtëse personale përkatësisht pajisjet personale mbrojtëse për qëllimin e caktuar, me kujdes t'i shfrytëzoj dhe cdo herë të janë në gjendje të rregullt.

(2) Për dëmtimin apo vjetërsimin e mjeteve mbrojtëse personale dhe pajisjeve personale mbrojtëse punëtori është i obliguar që në lidhje me këtë të njoftoj udhëheqësin e drejtpërdrejtë.

H. B

(3) Punëtori i cili nuk i shfrytëzon mjetet mbrojtëse personale përkatësisht pajisjet personale mbrojtëse për qëllimin e caktuar apo me qëllim i dëmton gjegjësisht nga pakujdesia i humbë është i obliguar që ta kompensoj vlerën.

Neni 28

Punëtori fiton të drejtën në mjetet mbrojtëse personale përkatësisht pajisjet personale mbrojtëse me rastin e lidhjes të marrëdhënies së punës në kohë të caktuar apo të pacaktuar, përkatësisht me rastin e sistemimit në vendin tjetër të punës si dhe pas kalimit të afatit të përcaktuar të qëndrueshmërisë, gjegjësisht në rastet kur mjetet mbrojtëse personale përkatësisht pajisjet personale mbrojtëse dëmtohen gjat kryerjes së punëve dhe detyrave të caktuara të punës, me deklaram me shkrim të udhëheqësit të drejtpërdrejtë për dëmtimin e shkaktuar gjat kryerjes së punëve dhe detyrave të punës.

Neni 29

Kërkesën për furnizim gjegjësisht lejim për dhënien e mjeteve mbrojtëse personale përkatësisht pajisjeve personale mbrojtëse për nevojat e punëtorit, përkatësisht punëtorëve për nevojat e ndërmarrjes për një përdorim ose përdorim të kohëpaskohshëm, përkatësisht përdorimit të përbashkët, shërbimi përkatës, respektivisht personit përgjegjës i ngarkuar me punët e mbrojtjes në punë, ia dorëzon depoisti, i cili është i detyruar ta përmbush të njëjtën.

V. MJETET PERSONALE MBROJTËSE DHE AFATI I QËNDRUESHMËRISË SIPAS PUNËVE DHE DETYRAVE TË PUNËS

Neni 30

(1) Punëtoret kanë të drejtë në mjetet mbrojtëse personale përkatësisht pajisjet personale mbrojtëse sipas llojit, sasisë dhe afatit të qëndrueshmërisë, varësisht nga punët dhe detyrat e punës si dhe nga lloji i mbrojtjes nga rreziku apo dëmtimet gjat punës duke llogaritur orarin e rregullt të punës përkatësisht ekspozimit ndaj rrezikut apo dëmtimit.

(2) Në vijim përcaktohet lloji i pajisjeve personale mbrojtëse si dhe afati i qëndrueshmërisë, të cilat i takojnë punëtorit sipas punëve dhe detyrave të punës:

A. B

NJËSIA AFARISTE UJI DHE CENTRALI ELEKTRIK

Nr.	Punët dhe detyrat e punës	Paisjet	Afati i Qëndrueshmërisë
1.1	Drejtori i NJA U&C	Bunda nga materiali kualitativ Çizme gome	3 vite 2 vite
1.2	Inxhinier për mirëmbajtjen e objekteve hidroteknike dhe mbrojtja nga ujërat	Mantil diolen, çizme gome të shkurta	1 vit 1 vit
1.3	Teknik për mirëmbajtjen dhe operimin e kanalit kryesorë dhe kanalet e hapura të ujitjes	Bunda Mantel pune Çizme gome	3 vite 1 vit 1 vit
1.4	Referent i dokumentacionit teknik të objekteve	Mantel pune diolen	1 vit
1.5	Punëtor në mirëmbajtjen e kanalit	Rroba të punës Çizme gome Bunda e thjeshtë Mantel shiu Dorëza të punës	1 vit 1 vit 3 vite 2 vite 1 vit
1.6	Operues i makinave ndërtimore	Rroba të punës Çizme gome Bunda e thjeshtë Dorëza të punës	1 vit 1 vit 3 vite 1 vit
1.7	Operues i pajisjeve hidromekanike	Rroba të punës Çizme gome Bunda e thjeshtë Dorëza të punës	1 vit 1 vit 3 vite 1 vit
1.8	Oskultues	Rroba të punës Çizme gome Bunda e thjeshtë Dorëza të punës	1 vit 1 vit 3 vite 1 vit

DIGA E PRIDVORICËS

A. B

1.9	Operues i pajisjeve hidromekanike	Rroba të punës Çizme gome Bunda e thjeshtë Dorëza të punës	1 vit 1 vit 3 vite 1 vit
1.10	Shef i shërbimit të elektromakinerisë	Mantel pune Çizme gome Bunda Dorëza të punës	1 vit 1 vit 3 vite 1 vit
1.11	Teknik për mirëmbajtjen dhe operimin e Shërbimit elektromakinerik	Bunda Mantel pune Çizme gome	3 vite 1 vit 1 vit
1.12	Teknik për pompa thithëse	Bunda Mantel pune Çizme gome	3 vite 1 vit 1 vit
1.13	Teknik për objekte ndarëse	Bunda Mantel pune Çizme gome	3 vite 1 vit 1 vit
1.14	Elektricitist për mirëmbajtje elektrike në HS Dhe shtëpiak	Bunda Mantel pune Çizme gome	3 vite 1 vit 1 vit
1.15	Operues-pompist në pompat thithëse (elektricitist, makinist dhe punëtor ndihmës)	Rroba të punës Çizme gome Bunda e thjeshtë Dorëza të punës	1 vit 1 vit 3 vite 1 vit
1.16	Operues në objektin ndarës (elektricitist dhe makinist për secilin objekt ndarës)	Rroba të punës Çizme gome Bunda e thjeshtë Dorëza të punës Rroba të punës	1 vit 1 vit 3 vite 1 vit 1 vit
1.17	Automekanik	Mantel pune Çizme gome	1 vit 1 vit

H. B

		Dorëza të punës	1 vit
1.18	Autoelektricit	Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	1 vit
		Dorëza të punës	1 vit

NJËSIA PUNUESE HIDROCENTRALI UJMAN

1.19	Udhëheqës i NJP HC Ujman	Bunda	3 vite
		Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	2 vite
1.20	Inxhinier i elektros	Bunda	3 vite
		Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	2 vite
1.21	Inxhinier i makinerisë	Bunda	3 vite
		Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	2 vite
1.22	Kryepunëtor për punë elektrike	Bunda	3 vite
		Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	2 vite
		Dorëza të punës	1 vit
1.23	Kryepunëtor për punë makinerike	Bunda	3 vite
		Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	2 vite
		Dorëza të punës	1 vit
1.24	Teknik për punë elektrike	Bunda	3 vite
		Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	2 vite
		Dorëza të punës	1 vit
1.25	Teknik për punë makinerike	Bunda	3 vite
		Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	2 vite
		Dorëza të punës	1 vit
1.26	Sertor	Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	1 vit

A.B

		Dorëza të punës	1 vit
1.27	Turbinist	Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	1 vit
		Dorëza të punës	1 Vit
1.28	Depoist	Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	1 vit
		Dorëza të punës	1 Vit

NJËSIA AFARISTE UJITJA

1.29	Drejtori I NJ.A "Ujitja"	Bunda nga materiali kualitativ	3 vite
		Çizme gome	2 vite
		Mantel pune	1 vit
1.30	Inxhinier i operativës dhe mirëmbajtjes	Bunda	3 vite
		Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	2 vite
		Dorëza të punës	1 vit

Njësia Punuese "Vushtrri"

1.31	Udhëheqësi i Njesisë Punuese	Bunda	3 vite
		Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	2 vite
		Dorëza të punës	1 vit
1.32	Inxhinier i bujqësisë	Bunda	3 vite
		Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	2 vite
		Dorëza të punës	1 vit
1.33	Teknik i ujitjes	Bunda	3 vite
		Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	2 vite
		Dorëza të punës	1 vit
1.34	Teknik i ndërtimtarisë	Bunda	3 vite
		Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	2 vite
		Dorëza të punës	1 vit

A.B

1.35	Operues i SP (operues dhe punëtor ndihmës)	Bunda Mantel pune Çizme gome Dorëza të punës	3 vite 1 vit 2 vite 1 vit
1.36	Evidentues - Administrator	Mantel pune Çizme gome Dorëza të punës	1 vit 1 vit 1 vit
1.37	Depoist	Mantel pune Çizme gome Dorëza të punës	1 vit 1 vit 1 vit
1.38	Drejtues i mekanizmit ndërtimtar Dhe automjetit të udhëtarëve	Bunda Rroba pune Çizme gome Dorëza të punës	3 vite 1 vit 2 vite 1 vit
1.39	Punëtor në mirëmbajtje	Bunda Rroba pune Çizme gome Dorëza të punës Mantel shiu	3 vite 1 vit 2 vite 1 vit 1 vit
1.40	Pastrues – Punëtor higjienik	Mantel pune Borosane (papuqe) Dorëza higjienike	1 vit 1 vit 1 vit

Njësia Punuese “Shkabaj”

1.41	Udhëheqësi i Njesisë Punuese	Bunda Mantel pune Çizme gome Dorëza të punës	3 vite 1 vit 2 vite 1 vit
1.42	Teknik i ujitjes	Bunda Mantel pune Çizme gome Dorëza të punës	3 vite 1 vit 2 vite 1 vit
1.43	Teknik i ndërtimtarisë	Bunda	3 vite

H.B

		Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	2 vite
		Dorëza të punës	1 vit
1.44	Evidentues - Administrator	Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	1 vit
		Dorëza të punës	1 vit
1.45	Laborant	Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	1 vit
		Dorëza të punës	1 vit
1.46	Depoist	Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	1 vit
		Dorëza të punës	1 vit
1.47	Drejtues i mekanizmit ndërtimtar dhe automjetit të udhëtarëve	Bunda	3 vite
		Rroba pune	1 vit
		Çizme gome	2 vite
		Dorëza të punës	1 vit
1.48	Punëtor në mirëmbajtje	Bunda	3 vite
		Rroba pune	1 vit
		Çizme gome	2 vite
		Dorëza të punës	1 vit
		Mantel shiu	1 vit
1.49	Pastrues – Punëtor higjienik	Mantel pune	1 vit
		Borosane (papuqe)	1 vit
		Dorëza higjienike	1 vit

Njësia Punuese “Komoran”

1.50	Udhëheqësi i Njesisë Punuese	Bunda	3 vite
		Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	2 vite
		Dorëza të punës	1 vit
1.51	Teknik i ujitjes	Bunda	3 vite
		Mantel pune	1 vit
		Çizme gome	2 vite
		Dorëza të punës	1 vit

A. B

1.52	Teknik i ndërtimtarisë	Bunda Mantel pune Çizme gome Dorëza të punës	3 vite 1 vit 2 vite 1 vit
1.53	Operues i SP (operues dhe punëtor ndihmës)	Bunda Mantel pune Çizme gome Dorëza të punës	3 vite 1 vit 2 vite 1 vit
1.54	Evidentues - Administrator	Mantel pune Çizme gome Dorëza të punës	1 vit 1 vit 1 Vit
1.55	Depoist	Mantel pune Çizme gome Dorëza të punës	1 vit 1 vit 1 vit
1.56	Drejtues i mekanizmit ndërtimtar Dhe automjetit të udhëtarëve	Bunda Rroba pune Çizme gome Dorëza të punës	3 vite 1 vit 2 vite 1 vit
1.57	Punëtor në mirëmbajtje	Bunda Rroba pune Çizme gome Dorëza të punës Mantel shiu	3 vite 1 vit 2 vite 1 vit 1 vit
1.58	Pastrues – Punëtor higjienik	Mantel pune Borosane (papuqe) Dorëza higjienike	1 vit 1 vit 1 vit
		Çizme gome Dorëza të punës	2 vite 1 vit

Shërbimi për çështje të pronësisë

1.59	Shef i shërbimit	Bunda Mantel pune Çizme gome	3 vite 1 vit 2 vite
1.60	Inxhinier i gjeodezisë Sistemi gjeografik i informimit	Bunda Mantel pune	3 vite 1 vit

A-B

Çizme gome

2 vite

Shërbimi i sigurimit fizik të objekteve dhe mbrojtjes në punë dhe nga zjarri

1.61	Koordinator i shërbimit	Bunda	3 vite
		Rroba pune	1 vit
		Çizme gome	2 vite
1.62	Punëtor i sigurimi në drejtorinë qendrore	Uniforma e verës	2 vite
		Uniforma e dimrit	2 vite
		Këmisha te verës (2 copë)	2 vite
		Këmisha te dimrit(2 copë)	2 vite
		Këpucë te verës	2 vite
		Këpucë te dimrit	2 vite
		Bunda	2 vite
1.63	Roja në drejtori, Shkabaj, Komoran, Vushtrri	Uniforma e verës	2 vite
	HC Ujman, Penda Ujman	Uniforma e dimrit	2 vite
		Këmisha te verës (2 copë)	2 vite
		Këmisha te dimrit (2 copë)	2 vite
		Këpucë te verës	2 vite
		Këpucë te dimrit	2 vite
		Bunda	2 vite

VI. PËRGJEGJËSIA PËR MOS ZBATIMIN E RREGULLORES

Neni 31

(1) Në rast të mos pajisjes së punëtorëve me mjetet e mbrojtjes në punë, përgjegjësinë e mban punëdhënësi dhe drejtori respektiv.

(2) Në rast se punëtori, përkundër furnizimit me mjete të mbrojtjes në punë, gjatë orarit të punës dhe në vendin e punës, i ka hequr mjetet e mbrojtjes në punë, kryen shkelje të rëndë të detyrave të punës, për të cilën shkelje është përgjegjes edhe eprori i drejtpërdrejt.

(3) Kontrollimin e bajtjes, përkatësisht shfrytëzimit të pajisjeve të mbrojtjes në punë e përcjell punëdhënësi përmes drejtorit respektiv dhe personit përgjegjës për mbrojtjen në punë, të cilët në rast konstatimi se nuk janë duke u respektuar masat e mbrojtjes në punë sipas kësaj rregulloreje, janë të

A. B

detyruar ta largojnë punëtorin nga puna përkatësisht punishtja dhe të inicojnë procedurën përkatëse disiplinore kundër punëtorit dhe eprorit të drejtpërdrejt.

VII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 32

Mjetet dhe pajisjet të cilat punëtorët i kanë marrë para se të hyj në fuqi kjo rregullore, afati i qëndrueshmërisë së tyre vazhdon të aplikohet në pajtim me dispozitat e Rregulloreve në fuqi.

Neni 33

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregullore bëhen me procedurë të njëjtë sikur në procedurën për marrjen e të njëjtave.

Neni 34

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeshefi Ekzekutiv.

31.05.2010



Hajdar Beqa
Kryeshef Ekzekutiv